

20151474163

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR PUNËSIMIN E PERSONAVE
INVALIDË

Neni 1

Në Ligjin për punësimin e personave invalidë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 44/2000, 16/2004, 62/2005, 113/2005, 29/2007, 88/2008, 161/2008, 99/2909, 136/11 dhe 129/15), në nenin 20 në paragrafin 1 fjalët: “1 800 deri” shlyhen.

Paragrafi 2 ndryshohet si vijon:

“Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për shoqërinë mbrojtëse do t’i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni personit përgjegjës në shoqërinë mbrojtëse.”

Neni 2

Në nenin 20-a në paragrafin 1 fjalët: “1 800 deri” shlyhen.

Paragrafi 2 ndryshohet si vijon:

“Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për personin juridik do t’i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni personit përgjegjës në personin juridik.”

Neni 3

Në nenin 21 në paragrafin 1 fjalët: “1 800 deri” shlyhen.

Paragrafi 2 ndryshohet si vijon:

“Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për personin juridik do t’i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni personit përgjegjës në personin juridik.”

Neni 4

Neni 22 ndryshohet si vijon:

“Gjobë në shumë prej 2 000 euro në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet punëdhënësit nëse mjetet e marra nga Fondi i veçantë nuk i shfrytëzon në pajtim me nenin 16-a paragrafi 6 nga ky ligj.

Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për personin juridik do t’i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni personit përgjegjës tek punëdhënësi.

Gjobë në shumë prej 1 000 euro në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet për kundërvajtje personit invalid i cili në mënyrë të pavarur kryen veprimtari si tregtar individ nëse mjetet e marra nga Fondi i veçante nuk i shfrytëzon në pajtim me nenin 16-a paragrafi 6 nga ky ligj.

Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për personin invalid i cili në mënyrë të pavarur kryen veprimtari si tregtar individ do t’i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi 3 i këtij neni personit përgjegjës te tregtari individ.”

Neni 5

Neni 23 shlyhet.

Neni 6

Neni 24 ndryshohet si vijon:

“Gjobë në shumë prej 800 euro në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet drejtorit të Agjencisë nëse ndan mjete në kundërshtim me nenin 16 paragrafët 2, 5 dhe 7 nga ky ligj.”

Neni 7

Neni 24-a ndryshohet si vijon:

“Për kundërvajtje të parapara në këtë ligj procedurë kundërvajtëse mban dhe sanksion kundërvajtës shqipton gjykata kompetente.”

Neni 8

Pas nenit 24-a shtohet neni i ri 24-b, si vijon:

“Neni 24-b

Matja e lartësisë së gjobës për persona juridikë dhe tregtar individ bëhet në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.”

Neni 9

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për punësimin e personave invalidë.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.